



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic Prosecution
Autoriteti Kompetent

AD.nr.19/2024

Datë: 06.01.2025

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga avokati N.S., kundër A.V., Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 06.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore kundër A.V., Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pasi që duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057), veprimet e prokurores nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 16.12.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të të pandehurit A.K., avokati N.S., ka pranuar ankesën disiplinore kundër prokurores A.V., e cila është prokurore e çështjes penale PP/II.nr..., ku në këtë ankesë disiplinore, parashtruesi i saj ndër të tjera pretendon se Prokuroria Themelore në Prishtinë ka bërë sekuestrim të paligjshëm të armëve me marrjen e armëve të ligjshme nga ana e A.K., i cili është invalid i Luftës së UÇK-së, ku me këto veprime prokuroria është duke i shkaktuar dëm të lartcekurit. Në ankesën disiplinore, paraqitësi i saj kërkon që t'i kthehen armët e marra pa bazë ligjore invalidit të UÇK-së, i cili ka luftuar për lirinë e Kosovës dhe kjo çështje të procedohet për hetime disiplinore si dhe hetime penale.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Prokurores A.V.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Me datë 16.12.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore nën numrin AD.nr.19/2024.

Me datë 16.12.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimin e ankesës disiplinore dhe regjistrimin e saj.

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 16.12.2024, kemi pranuar ankesën disiplinore nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së pandehur A.K., avokati N.S., me pretendimet për shkelje disiplinore nga ana e prokurores A.V., e cila prokurore është në trajtim të çështjes penale të evidentuar nën shenjë PP/II.nr... Sipas parashtruesit të kësaj ankese disiplinore, prokuroria ka bërë sekuestrim të paligjshëm të armëve të A.K., ku në ankesën disiplinore parashtruesi i saj e rithekson disa herë se i njëjti është invalid i Luftës së UÇK-së, ku parashtruesi i kësaj ankese disiplinore pretendon se me këto veprime po i shkaktohet një dëm i madh ekonomik autorizuesit të tij, A.K. Në ankesën-kërkesën e tij për hetime disiplinore dhe penale ka kërkuar që t'i kthehen armët të cilat shteti ia ka marrë palës A.K. pa bazë ligjore si dhe të gjenden personat përgjegjës lidhur me rastin në fjalë, qofshin ata nga prokuroria apo nga policia.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurores A.V. lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/II.nr...

Deklarimet e Prokurores A.V. në raportin e dërguar më datë 24.12.2024

Prokurorja A.V., në raportin e saj të datës 23.12.2024, të dërguar përmes postës elektronike në zyrën e Kryeprokurorit-Autoritetit Kompetent më datë 24.12.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: *“ Me datë 25.07.2024, nga Policia e Kosovës, Njësia për Hetimin e Krimit të Organizuar-DHKOKR, kemi pranuar kallëzimin penal me numër..., kundër të dyshuarit B.K. nga Prishtina, në drejtim të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe ndaj të dyshuarit A.K. nga Prishtina, në drejtim të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.*

Kronologjia e rastit

- ☐ Me datë 23.07.2024 Njësiti DHKOKR ka zbatuar urdhëresën për kontroll me numër PNKR.nr.. të datës 22.07.2024, lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake lidhur me

kontrollin në shtëpinë e të dyshuarit B.K. ku në dhomën e të njëjtit është gjetur dhe sekuestruar një revole tipit TT me numër serik ..., dy karikatorët të së njëjtës armë, një karikator të një arme tjetër (nuk ka të dhëna), dy çanta krahu të lëkurës ku ishin të vendosura revolva me të dhënat si më lartë, si dhe 57 fishek cal. 7.62 mm, 3 fishek cal. 7.65 mm dhe 1 fishek 38 special SMB.

□ Ndërsa nga dhoma e fjetjes së prindit të tij, këtu të dyshuarit A.K. janë gjetur dhe sekuestruar: Një armë pushkë gjuetie 1-tytëshe CZ USA,.... katër shtojca të tytës për të njëjtën armë; si dhe një revole (armë zjarri) e tipit Bereta ..., 33 fishek të armës së gjuetisë 12GA, 145 fishek cal.9x19mm, dy gëzhoja të fishekëve të gjuetisë 12GA, si dhe një armë pushkë gjuetie 2 tytëshe-vertikale Cifsan ..., katër shtojca të tytës për të njëjtën armë; Armë-pushkë Flapieta Chronos me dylbi si dhe një revole armë zjarri e tipit Beretae të cilat armë janë sekuestruar në bazë të urdhrit të prokurorit të Krimeve të Rënda, D.H.

□ Vërtetim për sekuestrim të armëve datë 23.07.2024 me numër të rastit

Veprimet hetimore

Pas pranimit dhe analizimit të rastit me datë 24.10.2024 kemi marrë Aktvendim për fillim të hetimeve kundër të pandehurit B.K. nga Prishtina, në drejtim të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe kundër të pandehurit A.K., nga Prishtina, në drejtim të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Është lëshuar Urdhëresë për ekspertizë balistike lidhur me armët e sekuestruara, për të cilat nuk ishte siguruar leje për posedim nga organet kompetente. Me datë 24.10.2024 është marrë deklarata në procedurë paraprake e të pandehurit B.K., në prezencë të avokatit F.M, i caktuar sipas detyrës zyrtare. Me datë 24.10.2024 është marrë deklarata në procedurë paraprake e të pandehurit A.K., në prezencë të avokatit sipas autorizimit N.S. Nga i pandehuri A.K. janë gjetur dhe sekuestruar pesë armë zjarri me të dhënat si më lartë ku nga Policia e Kosovës ceket se nga armët e sekuestruara për tri armë posedon leje valide për posedim lëshuar nga organi kompetent megjithatë me urdhër të prokurorit të krimeve të Rënda janë sekuestruar, ndërsa për dy armët tjera posedon vetëm kontratë për blerje të armës por që ende nuk është siguruar leja nga organi kompetent. Konsideroj se në rastin konkret veprimet hetimore nga ana ime si prokurore janë ndërmarrë në kohë të arsyeshme, duke marrë parasysh ngarkesën me lëndë dhe seanca gjyqësore që mbizotëron në Prokurorinë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm.”

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se në veprimet e ndërmarra nga prokurorja A.V., prokurore e cila është në trajtim të çështjes penale PP/II.nr..., nuk janë shprehur shkelje disiplinore të sanksionuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent ka ardhur deri te ky përfundim pas analizimit të pretendimeve nga ankesa disiplinore e palës ankuese, pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga ana e prokurores A.V., kundër së cilës është paraqitur kjo ankesë disiplinore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës penale PP/II.nr... dhe rrjedhës së procedurës në këtë çështje penale, e nga të gjitha këto shqyrtime dhe analizime kemi ardhur te ky përfundim, se prokurorja në fjalë nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Pretendimet e parashtruesit të kësaj ankese disiplinore se prokuroria kundërligjshëm ka sekuestruar armët e të pandehurit A.K. nuk qëndrojnë, kjo për faktin se urdhri për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm është lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë më datë 22.07.2024, andaj sekuestrimi i armëve të të pandehurit A.K. është një ndërveprim i Prokurorisë Themelore në Prishtinë së bashku me Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjithmonë në zbatim të dispozitave që dalin nga Kodi i Procedurës Penale. Fakti se i pandehuri kishte poseduar dy armë pa leje e vërteton edhe vet deklarata e tij e dhënë në polici më datë 23.07.2024 si dhe në deklarin e tij pranë prokurorit të shtetit më datë 24.10.2024, ku thekson se gjatë bastisjes në shtëpinë e tij, nga policia i ishin gjetur pesë (5) armë, nga të cilat tre armë i kishte me leje përkatëse ndërkaq dy armët e tjera nuk kishte ende leje por vetëm kontrata të shitblerjes.

Autoriteti Kompetent në shqyrtim të kësaj çështje disiplinore nuk ka evidentuar asnjë dëm që i ka shkaktuar palës A.K. nga veprimet e prokurores A.V., respektivisht, veprimet e prokurores në fjalë janë karshi autorizimeve dhe përgjegjësi të saj si prokurore e shtetit. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kësaj ankese disiplinore për hetime disiplinore dhe penale, është shumë e rëndësishme dhe relevante për çështjen të theksojmë se Ligji për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.08/L-167), në nenin 39, paragrafi 1 ka ofruar mbrojtje për këtë kategori, duke përcaktuar se: *“Prokurorët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për veprimet e ndërmarra, vendimet e marra, apo mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësi të tyre”*.

Theksimet e parashtruesit të kësaj ankese disiplinore se A.K. është invalid i UÇK-së, nuk janë relevante për këtë çështje. Kushtetuta e Republikës së Kosovës si akti më i lartë i këtij shtetit ka përcaktuar në nenin 24 detyrimin që të gjithë të trajtohen të barabartë para ligjit, andaj në këtë drejtim, pavarësisht statusit apo pozitës, Prokurori i Shtetit i trajton të gjithë personat të barabartë.


Kërkesa e palës ankuese se duhet gjetur personat përgjegjës qofshin nga policia apo prokuroria lidhur me dëmin që i është shkaktuar A.K., si Autoritet Kompetent theksojmë se në veprimet e prokurores së çështjes A.V. nuk kemi gjetur shkelje disiplinore, ndërkaq karshi pretendimeve dhe dyshimeve për shkelje nga ana e zyrtarëve policorë, nuk kemi kompetencë që këto pretendime t'i shqyrtojmë apo mbi të njëjtat të vendosim. Kryeprokurori si Autoritet Kompetent, ka kompetencë në trajtimin e ankesave disiplinore drejtuar prokurorëve të cilët veprojnë në prokurorinë me të cilën ai kryeprokuror administron, dhe jo edhe të akterëve të tjerë të procedurës penale.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se pretendimet e deklaruar në Ankesën disiplinore nuk paraqesin shkelje disiplinore, respektivisht ankesa disiplinore është e pabazuar, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar që veprimet e prokurores A.V. paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR**.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

AUTORITETI KOMPETENT KRYEPROKURORI



Vendimi i dërgohet:

-Këshillit Prokurorial të Kosovës

-Arkivës